



RAPORT MONITORIMI
MJEDISI & TURIZMI
Nëntor 2020 -Janar 2021

AUTOR
Tea Zeqaj

QENDRESA
QYTETARE



NED National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al

Raport monitorimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Nëntor 2020- Janar 2021

Cilësia e ajrit, transparenca

Në përpjekjet e vazhdueshme njerëzore për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, duket se çdo herë e më shumë fokusi është vendosur tek mirëqenia e shëndetit (mendor dhe fizik), marrëdhëniet njerëzore dhe një jetesë e qëndrueshme për gjeneratat që po vijnë. E teksa jeta e njeriut është e lidhur ngushtë me ekosistemin që e rrethon, cilësia e mjedisit dhe në veçanti cilësia e ajrit ruajnë një rol kritik në mirëqenien e çdo qytetari.

Monitorimi i cilësisë së ajrit është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Institutit të Shëndetit Publik, Inspektoratit përgjegjës për mjedisin dhe njësisë të vetqeverisjes vendore. Këto institucione gjenerojnë të dhëna nga monitorime në disa qytete të Shqipërisë dhe në bazë të rezultateve sugjerojnë dhe nxisin institucionet lokale dhe qendrore të hartojnë politika dhe të marrin masa në dobi të shëndetit të qytetarëve.

Pavarësisht kësaj, një sërë problematikash janë hasur qoftë më mangësinë dhe saktësinë e të dhënave të gjeneruara, transparencën dhe aksesimin e këtyre të dhënave dhe ç'është më e rëndësishmja me përkeqësimin e cilësisë së ajrit, rrjedhimisht shëndetit të qytetarëve.

Nisur nga tendencat rritëse të ndotjes së ajrit dhe faktit që qeveria nuk ka ndërmarrë masat e duhura në funksion të përafrimit të legjislacionit, disa orgnizata mjedisore të shoqërisë civile krijuan platformën Green Lungs: Mushkëri të gjebra për qytetet tona. Një iniciativë financuar nga Bashkimi Evropian e cila solli një matje alternative të cilësisë së ajrit duke i bërë transparente të gjitha të dhënat e grumbulluara një disa qytete të Shqipërisë.

Studime të shumta tregojnë mbi kostot që ka ndotja e ajrit në jetën e qytetarëve, teska këto kosto me kalimin e kohës po bëhen çdo ditë e më

të vështira për t'u llogaritur. Një raport i ri i OSBE¹, "Pasojat Ekonomike të ndotjes së ajrit", vlerëson se deri në vitin 2060, ndotja do të shkaktojë 6-9 milion vdekje të parakohshme. Rastet e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare po rriten dhe kostot globale të të gjitha këtyre humbjeve nga ndotja parashikohen të arrijnë 18-25 trilionë në vit deri në 2060, para këto, të cilat vet qytetarët do të ishin të gatshëm t'i paguanin për të përmirësuar cilësinë e mjedisit por edhe qeveria me politikën që do të duhet të ndërmerret.



Sipas studimit të publikuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit², Shqipëria renditet në vendin e dytë sa i përket vdekjeve të shkaktuara nga ndotja e mjedisit. 23% e vdekjeve në Shqipëri kanë si arsye faktorët mjedisorë që lidhen me ndotjen e ajrit, zhurmën, kimikatet dhe mungesën e hapësirave të gjelbra.

Për më tepër, cilësia e ajrit ndikon në planifikimin urban të shumë qytetarëve të cilët vendosin lidhur me vendodhjen e banesës, biznesit apo vendodhja e një institucioni si shkolla dhe spitale.

Nisur nga të gjitha zhvillimet e fundit mbi intensifikimin e ndotjes së ajrit, mungesën e të dhënave të mjaftueshme dhe të sakta, shqetësimet e shtuara shëndetsore dhe mungesën e transparencës, ky raport monitorimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nga Qëndresa Qytetare do të fokusohet pikërisht te ndotja e ajrit, burimet e ndotjes, pasojat dhe burimet e informimit të qytetarëve.

¹ <https://www.project-syndicate.org/commentary/human-cost-of-air-pollution-by-simon-upton-2016-08?barrier=accesspaylog>

² <https://www.eea.europa.eu/publications/healthy-environment-healthy-lives?fbclid=IwAR0hNr-j7lx19fqQFSi9fJG5tldGtYUUEiiz89EMCxuec1IIIXIM0PDtIV0>

Kuadri Ligjor

Plani kombëtar i menaxhimit të cilësisë së ajrit³ është mjete planifikues, me anë të të cilit Qeveria shqiptare synon zbatimin e direktivës 2008/50/EC¹ mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në ambient, si dhe direktivave bijë përkatëse. Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ky plan ndjek dy objektiva: 1. përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkaluar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një risk i lartë i tejkalimit të këtyre limiteve; 2. ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën e ngelur të territorit. Këto objektiva do të arrihen duke implementuar masa, për të mos lejuar dhe për të reduktuar shkarkimet nga trafiku, burimet industriale apo burimet difuze, me qëllim për t’iu përmbajtur limiteve të përcaktuara nga ligji.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka rolin koordinues dhe raportues kundrejt përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian, në kuadër të kapitullit 27 “Mjedi”, si e tillë është detyrim i MTMs që të kontribuoj në hartimin e atyre politikave dhe akteve ligjore të cilat bëjnë të mundur arritjen e detyrimeve të vendosura në indikatorët e performancës të dokumenteve strategjike të institucioneve kontribuese në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

³ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf>

Sektorët e ekonomisë dhe ndikimet respektive në ndotjen e ajrit sipas MTM⁴

Transporti



Sektori i transporteve është kontributori më i madh, për sa u përket shkarkimeve të përgjithshme në ajër, por kontributi ekzakt duhet të përcaktohet saktësisht. Shkarkimet e CO₂ nga transporti (% e djegies totale të karburantit) në Shqipëri janë matur në masën 59.95% më 2011 dhe në masën 58.2% më 2012. (Burimet: Banka Botërore dhe Indikatorët e Zhvillimit të Botës, 2015). Përqendrime të larta të grimcave dhe të oksideve të azotit NO₂ janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura afër rrugëve me trafik të dendur në Tiranë dhe ka një pranim universal që trajtimi i problemit të transportit është çelësi për përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytet. Bllokimet nga trafiku për shkak të menaxhimit joeficient të tij, rrisin shkarkimin e këtyre ndotësve.

Industria



Zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Matjet e CAM-it kanë treguar probleme serioze për grimcat në Elbasan, të shkaktuara nga industria metalurgjike, fabrika e çimentos dhe nga depozita të hapura. Në zonën e Fierit, matjet indikative kanë regjistruar probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës.

⁴ Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Bujqësia



Kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrisë janë shumë të dëmshme ndaj mjedisit natyror dhe gjithashtu, mund të përbëjnë një problem edhe për njerëzit. Pesticidet e përdorura për të vrarë insektet që ushqehen me të korra, mund të shkaktojnë një dëm të madh në mjedis, nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur. Metani i çliruar nga "proceset e keqtrajtjes së ushqimit", si pasojë e kequshqyerjes së lopëve, është gjithashtu një lloj gazi serrë, duke e shndërruar kështu pjesërisht në një përgjegjës për ngrohjen globale. Shkarkimet nga përdorimi i karburanteve nga traktorët dhe pajisje të tjera të fermave të përdorura në bujqësi, gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Zjarret, të cilët nuk janë të pazakonshme në ferma, mund të jenë shumë të dëmshëm për mjedisin, nëse plehrat dhe mbetjet që vijnë nga ky sektor, digjen në mënyrë të pakontrolluar. Një draftshënim i vendit (2009), i hartuar nga Banka Botërore, tregoi se agrikultura në Shqipëri është përgjegjëse për 77% të metanit në vend dhe 91% të shkarkimeve të oksidive të azotit. Njësoj si me emetime të tjera sektoriale, kërkohet informacion më i përditësuar dhe më i saktë në lidhje me kontribuimet relative të gazeve me efekt serrë, substancave ozonholluese dhe ndryshimeve klimatike.

Zhvillimi urban



Tradicionalisht aktivitetet ndërtimore janë kontribuesit kryesor në përqendrimin e lartë të grimcave në ajër. Në zonat e ndërtimit, përveç aktiviteteve ndërtimore që natyrisht kanë kontributin e tyre, një kontribues i rëndësishëm mund të jetë edhe trafiku, rrugët dhe zonat e pasistemuara dhe qëndrimi pezull i grimcave të ngurta.

Menaxhimi i mbetjeve



Ka katër landfille sanitare dhe një impiant për incinerimin (djegien) e mbetjeve shtëpiake në Shqipëri në Elbasan dhe dy të tjerë në ndërtim në Tiranë dhe Fier . Mbetjet ruhen në vendgrumbullime të mbetjeve, dhe sasia e tyre reduktohet nëpërmjet zjarreve të pakontrolluara që shkaktojnë probleme në afërsi të depozitave. Djegia e pakontrolluar e mbetjeve shtëpiake përbën një burim të rëndësishëm të emetimit të dyoksinës. Ky problem vazhdon të bëhet më i madh, sepse shtresa më e varfër e popullsisë beson se djegia e këtyre mbetjeve është një metodë e pranueshme e asgjësimit të mbetjeve. Nga ana tjetër, Incineratorët pas djegies së mbetjeve gjenerojnë CO2 dhe gaze të tjerë, të cilët nëse nuk përdoren rregullisht filtrat si në rëstin e incineratorit të Elbasanit, janë shumë të dëmshëm për shëndetin e banorëve të zonës dhe më gjerë.

Situata aktuale e ndotjes së ajrit në Shqipëri


Raporte të shumta të Agjencisë Evropiane të Mjedisit, matje të vet institucioneve kombatare por edhe shkrime të shumta të gazetarëve kanë treguar se cilësia e ajrit në Shqipëri, sidomos në disa qytete është alarmante dhe po shkatërron ngadalë shëndetin e banorëve.

Në vitin 2016, sipas të dhënave të INSTAT vdekjet e shkaktuara nga tumoret janë rritur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë, ku nëngrupi i sëmundjeve „tumor në mushkëri“ përbën 20,4 %.



Pneumologët tregojnë se ato që po dëmtojnë mushkëritë e shqiptarëve, janë grimcat që thithin çdo ditë nëpërmjet ajrit të shkaktuar nga karburanti i automjeteve, mjetet e vjetra, pluhuri apo tymi që del nga djegia e mbeturinave.⁵

Lung cancer most deadly respiratory disease in Albania 2012



Source: World Health Organization • Get the data • Created with Datawrapper

Numri i vdekjeve nga kanceri i mushkërive në vitin 2012 në Shqipëri. Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, 80% e vdekjeve të parakohshme nga infarkti dhe sëmundjet e zemrës, 14% e vdekjeve nga sëmundjet kronike obstruktive pulmonare ose sëmundjeve akute pulmonare, dhe 6% të vdekjeve nga kanceri i mushkërive lidhet me ndotjen e ajrit urban.

Sipas të dhënave të publikuara në Raportin Vjetor të Qeverisjes Lokale në Ballkanin Perëndimor, flota e vjetëruar e autobusëve të Tiranës është ndër shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit në norma të rrezikshme. Flota e transportit publik në Bashkinë Tiranë, e përberë prej 305 mjetesh, rezulton të kemi shkarkime vjetore në ajër rreth 22.000 ton (PM, HC, CO₂, NO_x etj)⁶.

⁵ <https://citizens-channel.com/2017/07/20/pneumologet-ndotja-e-ajerit-po-ha-mushkerite-e-shqiptareve/>

⁶ <https://citizens-channel.com/2020/02/04/studimi-flota-e-vjeter-prej-305-autobusesh-ndotesi-kryesor-i-ajrit-ne-kryeqytet/>

Burimet kryesore të ndotjes në Shqipëri

Lënda grimcore (P M - P M 1 0 dhe PM2.5)

Përqendrime të PM-ve përfshijnë grimca të emetuara direkt në atmosferë nga burimet e djegies dhe grimca dytësore të formuara nga reaksione kimike në ajër. Në Shqipëri burimet më të mëdha njerëzore janë impiantet stacionare rezidenciale, të cilat përbëjnë rreth 74% të totalit.

Ekspozim në terma afatshkurtër dhe afatgjatë mund të përkeqësojë sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe rritjen e vdekshmërisë. Gjithashtu një nga kontribuesit kryesorë në ndryshimet klimatike.

Oksidet e Azotit (NOx)

Dyoksidi i azotit (NO₂) dhe monoksidi i azotit (NO) janë të dy okside azoti dhe të dy së bashku referohen si (NOx). Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së dhe ozonit. Kontribuon në acidifikimin dhe eutrodikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.

Ozoni (O₃)

Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike, që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NOx, dhe përbërjet organike të avullueshme (volatile) VOC, të iniciuar nga rrezatimi i fortë diellor. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Mund të shkaktojë dëmtime në bimë, duke çuar në uljen e prodhimit dhe ndikimit në biodiversitet. Ozoni është gjithashtu GES.

Diosksidi i Sqfurit (SO₂)

Ka për origjinë djegien e karburanteve që përmbajnë sqfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së Kontribuon në acidifikimin dhe eutrodikimin e tokës dhe

ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.

Benzeni

Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përfthimi nga djegiet shtëpiake, si dhe nga transporti rrugor. Ekspozimi i njerëzve ndaj benzenit është i lidhur me një sërë sëmundjesh dhe efektesh në shëndet, akute dhe afatgjata, përfshirë kancerin dhe anemone plastike.

Plumbi (Pb)

Shkarkohet nga djegia e qymyrit dhe gjithashtu nga industria e prodhimit të hekurit dhe çelikut, si dhe metaleve joferrore. Plumbi akumulohet në gjak, kocka, muskuj dhe dhjam, dhe ka ndikim negativ në tru, nerva, zemër dhe gjak. Të miturit dhe fëmijët e vegjël janë veçanërisht të ndjeshëm edhe ndaj niveleve të ulëta të plumbit.

Burimet e informimit mbi cilësinë e ajrit

Nëse do të vëzhgojmë studimet dhe raportet që pasqyrojnë cilësisë së ajrit në vend, vihet re se nuk ka të dhëna të mjaftueshme, madje edhe ato që ekzistojnë janë të vjetra, të papërditësuara dhe bien ndesh mes disa burimesh informimi. Në raportin e vitit 2018⁷ të gjendjes së mjedisit (RGJM), ndotja e ajrit shfaqet thjesht në kopertinë, por rubrika ku duhet të trajtohej në brendësi mungon. Sipas RGJM e vitit 2018, nënvizohet se monitorimi i cilësisë së ajrit urban për vitin 2018 me stacionet automatik nuk është realizuar për shkak të pamundësive për të realizuar kualidimin e aparaturave, ndërkohë që cilësohet se në zonat kryesore urbane është përmirësuar mesatarisht mbi 30 %, por problematike ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ndaj ndotjes, si pasojë e tejkalimit të normës vjetore të ditëve të ndotura. Ndërsa në po të njëjtin lloj raporti të vitit 2017, ndotja e ajrit trajtohet, edhe pse në një hapësirë të vogël të raportit në krahasim me temat e tjera mjedisore.

⁷ <http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

Nga ana tjetër, Shqipëria është një ndër të paktat vende që nuk jep asnjë të dhënë mbi parametrat e ndotjes në Indeksin e Cilësisë së Ajrit (The World Air Quality Index)⁸. Vendi ynë shfaqet thjesht si një zonë gri në hartën botërore, i ndjekur nga një shënim ku thuhet: “Nuk ekziston asnjë informacion i qartë me të dhënat në kohë reale qoftë nga projekti SELEA ose Ministria e Mjedisit.”

Një audit i KLSH⁹ del në konkluzionin se” “Ka mospërputhje midis Programeve Vjetore të Monitorimit të Mjedisit dhe Raporteve të Gjendjes së Mjedisit. Nuk respektohet dhe nuk përshkruhet saktë metodologjia e ndjekur për raportimin e rezultateve të monitorimit të cilësisë së ajrit.” Në raport nxirret në pah edhe mungesa e komunikimit mes institucioneve përgjegjëse për moniotrimin e ajrit, AKM dhe ISHP, ku kjo e fundit “nuk ka akses në të dhënat e treguesve të cilësisë së ajrit që monitorohen nga AKM”.

Nisur nga nevoja e qytetarëve mbi informimin rreth cilësisë së ajrit në zonat e tyre të banimit për qëllime strehimi apo aktivitete të tjera, ekipi i Qëndresës Qytetare i dërgoi një kërkesë për informacion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të kuptuar se si mundën qytetarët të informohen rreth kësaj çështjeje, por nuk morëm asnjë përgjigjie.

Bazuar në kërkimet tona në rrjet, qytetarët mund të mësojnë rreth cilësisë së ajrit nëpërmjet këtyre burimeve:

1. Faqja e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
2. Faqja Green Lungs
3. Instituti i Shëndetit Publik
4. Aplikacioni Tirana Ime dhe aplikacione të tjerë

⁸ <http://aqicn.org/faq/2015-04-28/real-time-air-quality-in-the-balkan-peninsula/?fbclid=IwAR3cbCQTU00E5dJafwoPwTv2wBFikf9mpKG1z84M8rn0HRI0Kdws9QQO G0>

⁹ http://citizens-channel.com/wp-content/uploads/2018/02/203_vendim_cilesia_e_ajrit_203_date_29_12_2017_3800-1.pdf

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Në faqen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit publikohen periodikisht raporte vjetore të cilat paraqesin gjendjen në mjedis, përfshirë cilësinë e ajrit. Raporti i fundit i publikuar është ai i vitit 2019, vit gjatë të cilit janë monitoruar PM10, PM2.5, NO2, SO2, O3, CO dhe BTEX, në qytetet kryesore : Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Korçë.

TE DHENAT MESATARE 2019

| Mesatare | SO2 | O3 | CO | NO2 | PM10 | PM2.5 | Benzen |
|----------|-------|------|------|-------|-------|-------|--------|
| Durres | 9.72 | | 0.87 | 15.64 | 24.03 | 12.33 | 0.88 |
| Elbasan | | 49.2 | 0.82 | 28.00 | | | |
| Korce | 16.71 | 64.0 | 1.76 | 16.02 | | | 1.66 |
| Shkoder | 11.73 | 78.3 | 1.51 | 9.65 | | | |
| Vlore | | 71.1 | 0.29 | 7.32 | 18.97 | 7.59 | 0.88 |
| Tirana | 25.68 | 31.7 | 0.48 | 37.85 | | | |

Figura 1. Të dhënat mesatare (ml/m³) sipas AKM të vrojtuar gjatë vitit 2019, në 6 qytete

2. Green Lungs

Platforma Green Lungs e projektit Mushkëri të gjelbra për qytetet tona, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Co-Plan - Instituti për Zhvillimin e Habitave dhe disa organizata mjedisore partnere në Tiranë, Durrës, Shkodër e Elbasan. Ky projekt është në vitin e tretë të zbatimit të tij dhe ka përditësuar vazhdimisht platformën elektronike me të gjëna për të gjitha qytetet e sipërpërmendura. Më poshtë tabela më të dhënat:

| Zona | Ajri | | | | | | | | | |
|-------------|-------|-------|-------|--------|-----|------|-----|-----|-------|-------|
| | PM2.5 | | PM10 | | CO | | CO2 | | NO2 | |
| | Max | Mes | Max | Mes | Max | Mes | Max | Mes | Max | Mes |
| Tirane (A) | 0.032 | 0.016 | 0.044 | 0.021 | 5.6 | 1.74 | 641 | 402 | 0.252 | 0.112 |
| Durres (A) | 0.064 | 0.031 | 0.126 | 0.036 | 6.1 | 1.64 | 981 | 487 | 0.77 | 0.086 |
| Elbasan (A) | 0.18 | 0.03 | 0.122 | 0.0222 | | | 443 | 373 | 0.65 | 0.075 |
| Shkoder (A) | 0.05 | 0.027 | 0.212 | 0.047 | 4 | 1.11 | 903 | 663 | 0.49 | 0.059 |

Figura 2. Të dhënat në Mikrogram për metër kub, burimi: Green Lungs



Nga 366 pika matjeje të cilësisë së ajrit në disa qytete, sipas platformës duket se dominojmë vlerat mbi normën e Bashkimit Evropian, shumë prej tyre janë shqetësuese.

Figura 3. Tirana, Green Lungs




Figura 4. Ndotja e ajrit në Tiranë, Green Lungs

Si rrjedhojë e niveleve të larta të ndotjes ekspertët kanë shpallur alarmin për disa nga zonat në Tiranë si dhe rekomandojnë shangjien e ekspozimit për një kohë të gjatë të qytetarëve, por në të njëjtën kohë reagimin e institucioneve për normalizimin e situatës.




Figura 5: Zonat që duhen shmangur në Tiranë, Green Lungs

3. Instituti i Shëndetit Publik

Instituti i Shëndetit Publik, si qendra Kombëtare në fushën e shëndetit publik, ka si mision zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve

Sektori i Cilësisë së ajrit ka funksionet e mëposhtme¹⁰:

- Zhvillimi dhe aplikimi i programeve për kontrollin e cilësisë së ajrit.
- Inventarizimi i burimeve të emetimeve (instalimet industriale, trafiku, djegie e instalimeve).
- Monitorimi i cilësisë së ajrit outdoor (ajri jashta mjediseve të mbyllura) dhe atij indoor (brenda mjediseve të mbyllura) dhe analizimi i efekteve në shëndetin e popullatës.

Të dhënat e fundit mbi monitorimin e cilësisë së ajrit nga Instituti i Shëndetit Publik, dhe të vetme, janë të viteve 2016, 2017¹¹. Ndërkohë, përpjekjeve të mediave për të mësuar numrin e të sëmurëve dhe llojet e sëmundjeve të viteve të fundit si pasojë e ndotjes së ajrit, ky institucion ka refuzuar t'ju përgjigjet.



¹⁰ <http://ëëë.ishp.gov.al/funksionet-e-ishp/>

¹¹ <http://ëëë.ishp.gov.al/ëp-content/uploads/2015/04/Te-dhenat-e-cilesise-se-ajrit-gazet-nga-st.-autom.-viti-2017.pdf>

4. Tirana ime

Aplikacioni Tirana ime është një tjetër burim informacioni mbi cilësinë e ajrit, por vetëm në Tiranë. Tirana ka stacionet e veta të monitorimit në katër pika: Ura tek Rruga e Elbasanit, Sheshi Skënderbej, Kryqëzimi 21 Dhjetori dhe Zyrat Qendrore Vodafone Albania. Ekipi i Qëndresës Qytetare monitoroi të dhënat që shfaqeshin në aplikacion, për t'i krahasuar këto të dhëna edhe me ato të gjeneruara nga AKM dhe

ekspertët mjedisorë. Aplikacioni informon mbi elementët: CO, SO₂, NO₂, O₃, PM_{2.5} dhe PM₁₀ dhe përditësimi i fundit ka qenë data 29.04.2020.



Sipas matjeve të Bashkisë Tiranë, ndotësit janë nën kontroll përveç Ozonit tek Rruga e Elbasanit.

Krahasimi

Nëse do ti vendosnim përballë të gjitha burimet e të dhënave, së pari do të dallonim se jo të gjitha elementet maten nga burimet pavarësisht rëndësisë dhe ndikimit negativ të tyre në shëndet. Nga kërkimet tona, zbuluam se kjo realizohet kryesisht për mungesë pajisjesh ose moskalibrimit të tyre aktuale për mungesë fondesh.

Nga ana tjetër, vihet re se PM10 dhe PM2.5 nuk janë matur nga AKM për vitin 2019 në qytetin e Elbasanit dhe Tiranës, dy qytetet me ajrin më të ndotur në vend. Ndërkohë të dhënat që disponohen nga Bashkia Tiranë dhe Green Lungs bien ndesh me njera tjetrën, teksa Green Lungs nxjerr shifra shqetësuese mbi normë, kurse Për Bashkinë Tiranë këto dy ndotës janë nën normë në të gjitha pikat e matura. Në media ekspërtët mjedisor në Elbasan janë shprehur: “Si rezultat i matjeve të parametrave të ajrit, gjatë 3 muajve të fundit të vitit 2018, ajo që bie në sy është përmbajtja e lartë e grimcave PM 2.5 dhe PM 10 në ajrin urban që arrin shifrat alarmante që rezultojnë mesatarisht 1.5 – 2 herë mbi normat e lejuara të vendeve të BE.” Mungesa e informacioni por edhe mospërputhja shkakton konfuzion tek qytetarët në aspektin e informimit, por ç’është më e rëndësishmja ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre.

Përpjekjet për monitorim të digjitalizuar, Rasti i Elbasanit

Qyteti i Elbasanit është një nga zonat më të ndotur në Shqipëri kryesisht për ndotjen e ajrit dhe njihet për pasojat e rënda që ndotja ka shkaktuar në shëndetin e banorëve.

Katër vjet më parë, bashkia e Elbasanit prokuroi ndërtimin e një sistemi informatik për monitorimin e cilësisë së ajrit. Por sipas monitorimeve të bëra ndaj aplikacionit Parametrat Ambientale¹² rezultoi se të dhënat nga sensorët mungojnë në shumicën e rasteve ose nuk janë të plota. Nëse hyn në faqe shfaqet një hartë pa të dhëna, dhe ato pak të dhëna që janë, nuk është e mundur të kuptohen nga qytetarët. Problem i këtij rasti nuk

¹² <http://79.106.162.242:3392/sensore/vizitor.php>

janë vetëm kostot e fryra të projektit por edhe mosvlerësimi i situatës shumë të rëndë mjedisore në të cilën ndodhet qyteti i Elbasanit.

Ndërkohë një tjetër problem i shtuar është shkëputja e Inspektoratit të mjedisit¹³ dhe kalimi i kompetencave te Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan. Reformimi i institucioneve ka sjellë një sërë problematikash dhe paqartësi rolesh, teksa 850 mijë banorë janë në funksion vetëm katër inspektorë. Rastet e ndjekura nga këto inspektorë janë vetëm dy raste zhurmash. Kurse Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan deklaroi se ka zhvilluar 45 kontrole për goditjen e krimeve mjedisore, prerjen e paligjshme të pyjeve dhe ndërtime pa leje maj-shtator 2020.

Sipas ekspertëve mjedisorë në Elbasan, nga 47 pika të matura, vetëm 4 prej tyre ishin brenda normave të BE-së, sa i përket përqendrimit të NO₂ në ajër.

“Specifikisht nga 40µg/m³ që është standardi i BE-së në pikat e tjera të dhënat variojnë nga 50 µg/m³ deri në 100 µg/m³ për NO₂”,-sqarojnë ekspertët.

Banorët shprehen gjithashtu të shqetësuar për mungesën e vendosjes së filtrave nga kompanitë, sidomos gjatë mbrëmjes, fakt që këto të funksit e mohojnë.

Por realiteti i pamohueshëm është se qytetarët e Elbasanit vuajnë gjithmonë e më shumë ndotjen e ajrit, teksa secili prej tyre mund të ndajë të paktën një rast humbjeje të një perosni të afërt prej problemeve me mushkëritë ose zemrën.

¹³ <https://citizens-channel.com/2020/11/23/elbasan-ristrukturimi-i-institucioneve-mjedisore-zvogelon-kontrollin-nderkohe-qe-ndotja-shtohet/#>

Rekomandime:

1. Monitorimi i cilësisë së ajrit të marrë vëmendjen e duhur dhe prioritarizim në buxhetim për pajisje dhe kapacitete njerëzore mbi monitorimin e shkarkimeve në ajër.

2. Monitorimi i cilësisë së ajrit në mjedisi, të jetë në linjë me kërkesat e BE-së. Të aplikohet sistemi i kontrollit të cilësisë së të dhënave për të siguruar të dhëna të sakta dhe të besueshme, Siguria dhe Kontrolli i Cilësisë të të dhënave QA/QC .

3. Të kryhet verifikimi i të dhënave të monitorimit, nga Inspektorati përgjegjës për mjedisin, të rritet numri dhe kapacitetet e inspektorëve.

4. Të implementimit një sistemi vlerësimi dhe monitorimi në kohë reale të niveleve të ndotjes, i cili është i aftë të marrë dhe të shpërndajë informacionet e nevojshme, për menaxhimin e duhur të cilësisë së ajrit për situatat e riskut.

5. Rritja e transparencës për investimet e reja, kontrollin e shkarkimeve në ajër, nxitja e bashkëpunimit me publikun dhe zbatimin e politikave të parashikuara.

6. Të merren masa emergjente për përmirësimin e cilësisë së ajrit sidomos në qytetet më të ndotura.

7. Të merren masa administrative ndaj ndotësve, qofshin këto kompani private apo shtetërore.

8. Të kenë kujdes të shtuar dhe dëmshpërblim banorët e prekur nga shqetësime shëndetësore si pasojë e ndotjes së ajrit.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE